

Për herë të parë, një shfaqje në bardhë e zi. Një Bomarshe me kostume shqiptare. Regjisori francez Eric Vigner tregon detajet e veprës dhe përvojës së parë me Teatrin Kombëtar në Tiranë

Berberi ala Marubi i Bomarshesë

ELSA DEMO

V

eshjet e aktorëve duhet të jenë me kostume të vjetra spanjolle, shkruan në prezantimin e aktit të parë të "Berberi i Seviljes" Pjer Bomarshe (Pierre Beaumarchais) 250 vjet të shkuara. Konti Almaviva, dashnor i fshehtë i Rozinës shfaqet në këtë akt i veshur me kilota sateni; është i mbështjellë me *manto* bojëkafë, ose me mantel spanjoll, kësulë të zezë e zbukuruar sipas formës me fjongo me ngjyrë. Në mars 2007, një regjisor francez, Eric Vigner, i përhëndet me kokë skicat e kostumeve të Anila Zajmit. "Mantelë të bardha dhe të zeza, kësula, dmth qeleshe si të kostumeve tradicionale të burrave tuaj, por të jenë sipas kokës. Më intereson forma... Ndërsa flokët të jenë një e kuqe natyrale". Në ekziston një "kinema kostumesh", fjala bie "Barry Lyndon" i Kubrickut apo "Maria Antuaneta" e Coppolas, ekziston dhe një teatër i tillë, ja ku Vinger-ja u vë një kryq parrukeve të mëdha dhe veshjeve me ngjyra të ndezura. Berberi i Bomarshesë së tij vjen për herë të parë në skenën e Teatrit Kombëtar në Tiranë me atmosferën e fotove të 900 të Marubit. Nëse një regjisori i duhet të shpikë një intrigë, Eric Vigner-së i ka pikuar kjo gjetje.

I lindur në Renë në 1960, Eric Vigner studioi teatër në vendlindje. Regjia e tij e parë është "La Place royale" i Kornejit (1988), dhe si aktor interpreton nën drejtimin e Jean-Pierre Miquel, Christian Colin, Brigitte Jaques, ndërsa në kinema xhiron me Philippe de Broca, Benoît Jacquot, Maria de Medeiros. Krijon një grup kërkimi teatral dhe themelon Kompaninë "Suzanne M." në vitet '90. Një vit më pas vë në skenë "Shiu i verës" i shkrimtares së njohur franceze Marguerite Duras, më pas "Njeriu i ri" i Jean Audureau-së, "Bukur" i Nathalie Sarraute-it, "Vij tek ty" i Gregory Mottonit. Në vitin 1995, është emëruar drejtor i qendrës dramatike të Bretanjes në Lori dhe atje ka vënë në skenë "Iluzionin komik" i Pjer Kornejit, "Akrobati" i Jean Genetit etj.. Me Komedinë Franceze ka vënë në skenë "Bajazet" i Rasinit, "Shkolla e grave" e Mollierit dhe "Savannah Bay" e Marguerite Durasit. Po ashtu ka realizuar regjinë e disa operave.

Më 19 prill dhe për tre netët në vazhdim do të ndjekim veprën e tij regjisoriale në Tiranë. Dje ishte dita e parë e punës me aktorët Roland Trebicka, Luiza Xhuvani, Helidon Fino, Neritan Liçaj...

Zoti Vigner si për bashkëpunimin e parë me Teatrin Kombëtar shqiptar, na thoni diçka më shumë për projektin "Berberi i Seviljes".

Është një projekt ndërmjet Shqipërisë dhe Francës, një bashkëpunim mes nesh për një komedi të vitit 1773 të Bomarshesë "Berberi i Seviljes" ose *Masa të kota*. Mbi këtë pjesë është bazuar opera me të njëjtin titull e Xhoakino Rosinit që u shfaq për herë të parë më 1816. Pse Bomarshe? Sepse kur u ftova që të realizoj diçka me aktorët e Teatrit Kombëtar dhe pasi takova disa prej tyre vendosa për një vepër klasike, jo tamam klasike, sepse Bomarshe është i shekullit të 18-të.

Pse Xhuvani, Trebickën, Finon...?


I kam ndjekur në skenë kur erdha për herë të parë në Shqipëri dhe mendova se atyre do t'iu shkonte kjo pjesë. Kjo nuk do të jetë e lehtë. Unë nuk flas shqip, por ama jam joshur shumë nga kultura shqiptare, nga ajo çfarë kam parë këtu, kostumet tradicionale, polifonia etj.. Imagjinata ime mori krah nga këto që pashë dhe dëgjova dhe vendosa: kjo do të ishte një shfaqje bardhë e zi.

Kemi dëgjuar vetëm për këtë deritani. Si do të jetë një shfaqje në bardhë e zi?

Ju e dini që bota nuk është krejt e zezë, as krejt e bardhë. Gjëja më interesante në jetë është bashkëpunimi i dritës dhe i errësirës, ose në kontekstin tonë i të bardhës dhe të zezës. "Berberi i Seviljes" ishte një komedi e re, një lloj i ri teatri në atë kohë në Francë, para Revolucionit Francez, dhjetë vjet para. Dhe sot është një lloj predikimi për lirinë, si mund të jemi të lirë, si mund të kalohet nga një botë e vjetër në një botë të re. Kjo është koha e ndryshimit. Për këtë do të punojmë dhe me aktorët, në këtë dritë shikimi të konceptit të veprës së Bomarshesë, si mund të ruajmë gjërat e mira për një rol në historinë e vendit me gjërat e traditës dhe si mund ta përfytyrojmë të ardhmen. Por kjo nuk mund të jetë e mundur nëse nuk njohim mirë të shkuarën, atë që e quajmë "botë e vjetër".

Pamë se për kostumet ju po frymëzoheni nga tradita shqiptare. Po e bëni këtë sepse shfaqja po realizohet në Shqipëri apo ka kjo zgjedhje edhe arsye estetike.

Jo nuk e bëj vetëm ngaqë jemi në Shqipëri. Kur erdha këtu për herë të parë kam parë fotot e Marubit. Më lanë shumë mbresë, nuk i kisha parë kurrë dhe ky ishte për mua një takim me traditën kulturore të Shqipërisë. Ashtu në bardhë



Regjisori francez Eric Vigner në tavolinën e punës në Teatrin Kombëtar
Foto: Armand Abazi/ALNA

e zi pashë një modë të vjetër të të fotografuarit. Më bëri përshtypje thjeshtësia e kostumeve dhe njëherësh një lloj artiskroacie mashkullore dhe femërore. Mendova se po, do t'ia vlenin për shfaqjen pasi edhe pjesa vetë na çon në shekullin e 18, sepse në të vërtetë jemi në atë

NË SHQIP

"Berberi i Sevilles" me nëntitull *Të marrësh masa të kota* i Pierre Beaumarchais (1732-1799) ka një përkthim shumë të mirë të Klio Evangjelit në shqip. Është vënë në skenën e teatrit të Vlorës në vitet '70, por asnjëherë në Teatrin Kombëtar. Komedia është në rendin e trilogjisë ku bëjnë pjesë "Martesa e Figaros" dhe "Nëna fajtores". Kjo trilogji është e rëndësishme sepse përfshin periudhën më të turbullt të historisë së Francës. Figaroja dhe Konti Almaviva, dy personazhet e Beaumarchais-së të konceptuar gjatë udhëtimit të tij në Spanjë, i gjen në të tre veprat. Ata janë dëshmitarë të ndryshimeve në pozicionet sociale para gjatë dhe pas Revolucionit Francez. Për herë të parë "Berberi" u shfaq në vitin 1775. Historia ndjek strukturën tradicionale të Commedia dell'Arte. Intriga përfshin një kont spanjoll, Almaviva (rolin e të cilit do ta interpretojë Roland Trebicka) i cili ka rënë në dashuri me një vajzë të quajtur Rozinë (Luiza Xhuvani). Për t'u siguruar se ajo do atë dhe jo paranë e tij, konti maskohet student i varfër. Planet i zbulohet nga Doktor Bartolo (Neritan Liçaj) i cili e mban Rozinën të mbyllur në shtëpi dhe pretendon të martohet vetë me të. Fati i Kontit ndryshon pas një takimi fatlum me ish shërbyesin e tij, Figaro (Helidon Fino) që punon berber dhe mund të hyjë në shtëpinë e doktorit. Figaro sajton mënyra që Konti dhe Rozina të takohen dhe në fund të martohen. Në role të tjera interpretojnë Marko Bitraku - Don Bazili, Fadil Kujovska - Noteri. Muzika është realizuar nga Fatos Qerimi, kostumet nga Anila Zajmi, skenografia nga vetë Eric Vigner i cili për të gjitha këto ka mbështetjen e asistent regjisorit Vasjan Lami. Inxhinieri i ndriçimit vjen po ashtu nga Franca.



Pierre Beaumarchais

gjetur një kuptim, një frymë të përbashkët ndërmjet kulturave shqiptare dhe franceze, pa pasur asnjë lloj imponimi me njëren kulturë apo me tjetrën sepse mënyra që kemi zgjedhur për të bashkëpunuar është teatri dhe gjuha e teatrit është universale.

Dy vjet më parë kam vënë në skenë "Borgjezin fisnik" në Korenë e Jugut. Unë jam gjithnjë i interesuar të takohem me kultura të tjera, duke u përpjekur për t'i kuptuar ato. Kjo është e vështirë dhe kërkon kohë. Shpresoj se do t'i japim publikut të Tiranës një vepër dhe një shfaqje të mirë falë këtij bashkëpunimi.

Kush është Eric Vigner? Përse bën teatër?

Unë jam regjisor dhe aktor teatri. Jam në botën e teatrit sepse besoj se është ndër më interesantët e arteve dhe më i vështiri pasi ka të bëjë me të gjitha: ka të bëjë me ndjenjat, me trupin, me muzikën, me hapësirën, pra me gjithçka. Është një art i vjetër dhe një art i drejtpërdrejtë. Teatri që bëj unë është ai që i vendos njerëzit përballë diçkaje si përpara një ekrani kinemaje apo televizionit, por që duhet të jenë "brenda diçkaje". Brenda diçkaje do të thotë brenda trupit, brenda karkasës së të shkruarit, brenda hapësirës po aq sa dhe brenda pranisë teatrale.

Çfarë është teatri i kohës sonë?

Teatri i kohës sonë është teatri që bëhet sot. Është akoma

“

Është besuar se mund të bëhet teatër për të shpëtuar dhe botën, por teatri nuk mund të shpëtojë botën. Ai vetëm është pjesëmarrës. Mendoj se teatri duhet bërë në një mënyrë shumë të thjeshtë, të përlurur, modeste


shpëtuar dhe botën, por teatri nuk mund të shpëtojë botën. Ai vetëm është pjesëmarrës. Mendoj se teatri duhet bërë në një mënyrë shumë, shumë të thjeshtë, të përlurur, modeste. Kjo do të thotë që nëse marrim pjesë në jetë, në shoqëri, në botë me këtë aktivitet, ta bëjmë këtë jo më shumë se ai që ecën, jo më shumë se ai që bën një kuzhinë të mirë, jo më shumë se ai që shkruan jo më shumë se etj., etj., pra do të thotë në të gjitha dhe në njëjtat nivele.

Cili është repertori dhe autorët tuaj?


Mua më pëlqejnë ata autorë që nuk bëjnë analiza sociale apo social-politike. Më pëlqejnë autorët që janë poetë ku spektatori mund të gjejë idetë e tij, të ndërtojë gjykimin e tij duke marrë shkas nga një vepër që tek e fundit është një vepër e hapur. Teatri social, teatri politik nuk është një teatër që më tërheq. Ka fusha të tjera intelektuale që merren me këtë, televizioni, gazetatat etj. Për fushën sociale flitet kaq shumë. Për mua nuk është me vlerë që teatri të merret edhe me këto çështje, me çështjet sociale pra.

Kur thua teatër thua edhe Komedi Franceze, sa identitet Franceze ka sot teatri juaj?


Identiteti francez është i lidhur me një histori të gjatë dhe pa ndërprerje të teatrit. Komedia Franceze që prej 350 vjetësh, që nga Moliერი, që nga shekulli i shtatëm-



Pierre Corneille



Marguerite Duras



Jean Genet

e pabesueshme që njerëzit kalojnë kohën duke u marrë me këtë. Ditë pas ditë ai po specifikohet. Besoj se po e kalon atë kohë komplekse, të vështirë, që ishte fundi i shekullit të njëzetë, një shekull i trazuar që ishte i tillë sepse shkaktoi dhe shkatërrimin e njeriut gjithashtu. Është besuar se mund të bëhet teatër për të

bëdhjetë është një teatër që s'ka reshtur kurrë se qeni me aktivitetin e tij, me trupën e tij të përherëshme. Kjo ka një domethënie shumë të rëndësishme për të thënë "[...]tre français". Kjo do të thotë: ja një histori që nuk është ndalur kurrë megjithë ndryshimet e qeverive, ndryshimet politike.

lloj mentaliteti, në ato lloj kup-timesh dhe të menduari.

Çfarë pretendoni të sillni me Bomarshenë ala Marubi?

Ky është takimi i parë për mua dhe është mirë që po punojmë së bashku. Para se të mbërrijmë tek rezultati unë po punoj përditë për të